

STANDARDI NDËRKOMBËTAR I AUDITIMIT 706 (I RISHIKUAR)

PARAGRAFËT QË THEKSOJNË ÇËSHTJEN DHE PARAGRAFËT PËR ÇËSHTJE TË TJERA NË RAPORTIN E AUDITUESIT TË PAVARUR

(Ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 Dhjetor 2016 ose pas kësaj date)

PËRMBAJTJA

	Paragrafi (ët)
Hyrje	
Objekti i këtij SNA-je	1-4
Hyrja në fuqi	5
Objektivi	6
Përkufizimet	7
Kërkesat	
Paragrafët në Raportin e Audituesit, të cilët Theksojnë Çështje	8-9
Paragrafët në Raportin e Audituesit, të cilët trajtojnë Çështje të Tjera	10-11
Komunikimi me Personat e Ngarkuar me Qeverisjen	12
Zbatimi dhe Materiale të Tjera Shpjeguese	
Marrëdhëniet midis Paragrafëve që Theksojnë Çështje dhe Çështjeve Kryesore të Auditimit në Raportin e Audituesit,	A1-A3
Rrethanat kur mund të jete i nevojshëm një Paragraf që Thekson Çështje	A4-A6
Përfshirja në Raportin e Audituesit e një Paragrafi që Thekson Çështje	A7-A8
Paragrafët për çështje të tjera në Raportin e Audituesit	A9 – A15
Vendosja në Raportin e Audituesit e Paragrafëve që Theksojnë Çështje dhe Paragrafëve për Çështje të tjera	A16-A17
Komunikimi me Personat e Ngarkuar me Qeverisjen	A 18
Shtojcë 1: Lista e SNA-ve që Përmbajnë Kërkesa për Paragrafët që Theksojnë Çështje	
Shtojcë 2: Lista e SNA-ve që Përmbajnë Kërkesa për Paragrafët për Çështje të Tjera	
Shtojcë 3: Ilustrimi i një Raporti të Audituesit që Përfshin një Seksion për Çështjet Kryesore të Auditimit, një Paragraf që Thekson Çështjen dhe një Paragraf për Çështje të Tjera	
Shtojca 4: Ilustrimi i një Raporti të Audituesit që Përmban një Opinion me Rezervë për shkak të një devijimi nga kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar dhe që përfshin një Paragraf që Thekson Çështje	

Standardi Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) 706 (i rishikuar), *Paragrafët në Raportin e Audituesit të Pavarur që Theksojnë Çështjen dhe Paragrafët për Çështje të Tjera* duhet të lexohet i lidhur ngushtë me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit (SNA) 200 *Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në Pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit*.

Hyrje

Objekti i këtij SNA-je

1. Ky Standard Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) trajton komunikimet shitesë në raportin e audituesit, kur audituesi konsideron të nevojshme:
 - (a) Të tërheqë vëmendjen e përdoruesve për një ose disa çështje të paraqitura ose shpjeguara në raportin e audituesit, të cilat janë të një rëndësie të atillë që është themelore për kuptimin nga përdoruesit të pasqyrave financiare; ose
 - (b) Të tërheqë vëmendjen për ndonjë çështje ose çështje të tjera përveç atyre të paraqitura ose të shpjeguara në pasqyrat financiare, që janë të rëndësishme për kuptimin nga përdoruesit, të auditimit, të përgjegjësive të audituesit ose të raportit të audituesit.
2. SNA 701¹ vendos kërkesa dhe jep udhëzime kur audituesi përcakton çështjet kryesore të auditimit dhe i komunikon ato në raportin e tij. Kur audituesi përfshin në raportin e tij një seksion për Çështjet Kryesore të Auditimit, ky SNA trajton marrëdhënien midis çështjeve kryesore të auditimit dhe ndonjë komunikimi shitesë në raportin e audituesit në përputhje me këtë SNA (Ref: Para. A1-A3)
3. SNA 570² (i rishikuar) dhe SNA 720 (i rishikuar)³ përcakton kërkesa dhe jep udhëzime rreth komunikimit në lidhje me vijimësinë, në raportin e Audituesit.
4. Shtojcat 1 dhe 2 identifikojnë SNA-të që përmbajnë kërkesa të veçanta për audituesin për të përfshirë në raportin e audituesit, Paragrafë që Theksojnë Çështje ose Paragrafë për Çështje të Tjera. Në këto rrethana, në lidhje me formën dhe vendosjen e këtyre paragrafëve, do të zbatohen kërkesat e këtij SNA-je.

Hyrja në Fuqi

5. Ky SNA hyn në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që përfundojnë me datën 15 Dhjetor 2016 ose pas kësaj date.

¹ SNA 701, *Komunikimi i Çështjeve Kryesore të Auditimit në Raportin e Audituesit të Pavarur*

² SNA 570 (i rishikuar), *Vijimësia*

³ SNA 720 (i rishikuar), *Përgjegjësitë e Audituesit në lidhje me informacionet e tjera*

Objektivi

6. Objektivi i audituesit, pasi ka formuar opinionin mbi pasqyrat financiare, është të tërheqë vëmendjen e përdoruesve, kur sipas gjykimit të audituesit kjo është e nevojshme të bëhet, nëpërmjet një komunikimi të qartë shtesë në raportin e audituesit për:
- (a) Një çështje, e cila edhe pse paraqitet siç duhet në pasqyrat financiare ose në shënimet shpjeguese, është e një rëndësie të madhe për kuptimin e pasqyrave financiare nga përdoruesit; ose
 - (b) Sipas rastit, ndonjë çështje tjetër, e cila ka lidhje me kuptimin nga ana e përdoruesve, të auditimit, të përgjegjësive të audituesit ose të raportit të audituesit.

Përkufizimet

7. Për qëllime të SNA-ve termat në vijim kanë këto kuptime:
- (a) Paragraf që Thekson Çështje – një paragraf që përfshihet në raportin e audituesit, i cili i referohet një çështjeje të paraqitur ose të shpjeguar në mënyrën e duhur në pasqyrat financiare, e cila sipas gjykimit të audituesit, është me shumë rëndësi, pasi është thelbësore për kuptimin e pasqyrave financiare nga ana e përdoruesve.
 - (b) Paragraf për Çështje të Tjera – një paragraf që përfshihet në raportin e audituesit, i cili shërben për të referuar një çështje tjetër, të ndryshme nga ato që janë paraqitur në pasqyrat financiare, dhe që, sipas gjykimit të audituesit, është e rëndësishme për kuptimin nga ana e përdoruesve, të auditimit, të përgjegjësive të audituesit ose të raportit të audituesit.

Kërkesat

Paragrafët në Raportin e Audituesit, të cilët Theksojnë Çështje

8. Nëse audituesi e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve për një çështje të paraqitur ose të shpjeguar në pasqyrat financiare, e cila është e një rëndësie thelbësore për kuptimin e pasqyrave financiare nga përdoruesit, ai duhet të përfshijë në raportin e tij një Paragraf që Thekson Çështjen me kusht që: (Ref: Para. A5-A6)

PARAGRAFËT QË THEKSOJNË ÇËSHTJEN DHE PARAGRAFËT PËR ÇËSHTJE TË TJERA NË RAPORTIN E AUDITUESIT TË PAVARUR

- (a) si rrjedhojë e kësaj çështje, audituesi të mos kërkohet të modifikojë opinionin në përputhje me SNA 705⁴ (i rishikuar); dhe
 - (b) kur zbaton SNA 701, çështja nuk duhet të jetë përcaktuar si çështje kryesore e auditimit për t`u komunikuar në raportin e audituesit (Ref: Para. A1-A3)
9. Kur audituesi përfshin në raportin e tij një paragraf që thekson çështjen, audituesi duhet:
- (a) Të përfshijë paragrafin brenda një seksioni të veçantë të raportit të audituesit, me një titull të përshtatshëm që përmban fjalët “Theksim i Çështjes”;
 - (b) Të përfshijë në paragraf një referencë të qartë për çështjen që theksohet dhe për vendin ku mund të gjendet në pasqyrat financiare informacioni përkatës që përshkruan plotësisht çështjen. Paragrafi do t`i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose të shpjeguar në pasqyrat financiare; dhe
 - (c) Të tregojë që opinionin e audituesit nuk është modifikuar për çështjen që theksohet (Ref: Para. A7-A8, A16-A17);

Paragrafët në Raportin e Audituesit, të cilët Trajtojnë Çështje të Tjera

10. Nëse audituesi e konsideron të nevojshme për të komunikuar një çështje tjetër, të ndryshme nga ato që janë paraqitur ose shpjeguar në pasqyrat financiare që, sipas gjykimit të audituesit është e rëndësishme për kuptimin nga ana e përdoruesve të auditimit, të përgjegjësive të audituesit ose të raportit të audituesit, audituesi do të përfshijë në raportin e tij një paragraf për çështje të tjera me kusht që:

- (a) Kjo nuk ndalohet nga ligji apo nga rregulli; dhe
- (b) Kur zbatohet SNA 701 çështja nuk duhet të jetë përcaktuar si çështje kryesore e auditimit për t`u komunikuar në raportin e audituesit (Ref: Para. A9-A14)

⁴ SNA 705 (i rishikuar) *Modifikimet e opinionit në raportin e audituesit të pavarur*

11. Kur audituesi përfshin në raportin e tij një paragraf për çështje të tjera, ai do ta përfshijë këtë paragraf brenda një seksioni të veçantë të titulluar “Çështje të Tjera” ose me një titull tjetër të përshtatshëm (Ref: Para. A15-A17).

Komunikimi me Personat e Ngarkuar me Qeverisjen

12. Nëse audituesi parashikon të përfshijë në raportin e tij një Paragraf që Thekson Çështje ose Paragrafë për Çështje të Tjera, ai duhet të komunikojë me personat e ngarkuar me qeverisjen lidhur me këtë parashikim dhe për formulimin e këtij paragrafi. (Ref: Para. A18)

Zbatimi dhe Materiale të Tjera Shpjeguese

Marrëdhëniet midis Paragrafëve që Theksojnë Çështje dhe Çështjeve Kryesore të Auditimit në Raportin e Audituesit (Ref: Para. 2,8(b))

A1. Çështjet kryesore të auditimit janë përkufizuar në SNA 701, si ato çështje që, në gjykimin profesional të audituesit, kanë qënë më të rëndësishmet në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Çështjet Kryesore të Auditimit zgjidhen nga çështjet e komunikuar me personat e ngarkuar me qeverisjen, dhe përfshijnë gjetje të rëndësishme nga auditimi i pasqyrave financiare të periudhës aktuale⁵. Komunikimi i çështjeve kryesore të auditimit jep informacion shtesë për përdoruesit e synuar të pasqyrave financiare dhe i ndihmon ata të kuptojnë këto çështje, të cilat në gjykimin profesional të audituesit kanë qënë më të rëndësishme në auditim dhe mund t'i ndihmojnë ata që të njohin dhe të kuptojnë entitetin dhe zonat ku drejtimi i entitetit ka bërë gjykime të rëndësishme, efektet e të cilave janë përfshirë në pasqyrat financiare të audituara. Kur zbatohet SNA 701, përdorimi i paragrafëve për theksimin e çështjes nuk zëvendëson përshkrimin individual të çështjeve kryesore të auditimit.

A2. Çështjet që sipas SNA 701 janë përcaktuar si çështje kryesore të auditimit, mundet që gjithashtu, në gjykimin e audituesit, të jenë thelbësore për përdoruesit që ata të kuptojnë pasqyrat financiare. Në këto raste, kur këto çështje komunikohen si çështje kryesore të auditimit në pajtim me SNA 701, audituesi mund të ketë dëshirë të nxjerrë në pah ose të tërheqë më tej vëmendjen tek rëndësia e saj relative. Audituesi mund ta bëjë këtë gjë duke i

⁵ SNA 260 (i rishikuar), *Komunikimi me Personat e Ngarkuar me Qeverisjen*, paragrafi 16

paraqitur çështjet sipas rëndësisë së tyre relative në mënyrë të dallueshme në seksionin e Çështjeve Kryesore të Auditimit (për shembull, sipas radhës, nisur nga rëndësia e tyre) ose duke përfshirë në përshkrimin e çështjes kryesore të auditimit, informacion shtesë që tregon për rëndësinë që ka kjo çështje për përdoruesit për të kuptuar pasqyrat financiare.

A3. Mund të ketë një çështje, që në përputhje me SNA 701, nuk është përcaktuar si çështje kryesore e auditimit (për shembull sepse kjo çështje nuk ka kërkuar vëmendje të madhe nga audituesi), por sipas gjykimit të audituesit ajo është thelbësore për përdoruesit për të kuptuar pasqyrat financiare (për shembull; një ngjarje e mëvonshme). Nëse audituesi e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve për këtë çështje, atëherë në përputhje me këtë SNA, kjo çështje do të përfshihet në raportin e audituesit, në paragrafin që thekson çështje.

Rrethanat kur mund të jetë i nevojshëm një paragraf që thekson çështje (Ref: Para. 4,8)

A4. Shtojca 1 identifikon standardet që përmbajnë kërkesa specifike për audituesin, për të përfshirë në disa rrethana paragrafë të theksimit të çështjeve në raportin e tij. Këto rrethana përfshijnë rastet kur:

- Një kuadër i raportimit financiar i përshkruar nga ligji ose nga rregullat do të ishte i papranueshëm, por zbatohet për faktin që ai është përshkruar nga ligji ose rregullat.
- Duhet të vihen në dijeni përdoruesit se pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtim me një kuadër raportimi për qëllime të veçanta.
- Për audituesin faktet bëhen të ditura pas datës së raportit të audituesit dhe audituesi jep një raport të ri ose të amenduar (d.m.th. ngjarjet e mëvonshme)⁶.

A5. Shembuj të rrethanave kur audituesi mund të konsiderojë të nevojshme të përfshijë një Paragraf që Thekson Çështje, janë:

- Një pasiguri në lidhje me rezultatin e ardhshëm të një çështje gjyqësore ose të një veprimi rregullator;

⁶ SNA 560, *Ngjarjet e mëvonshme*, paragrafët 12(b) dhe 16

PARAGRAFËT QË THEKSOJNË ÇËSHTJEN DHE PARAGRAFËT PËR ÇËSHTJE TË TJERA NË
RAPORTIN E AUDITUESIT TË PAVARUR

- Një ngjarje e mëvonshme sinjifikative që ndodh midis datës së pasqyrave financiare dhe datës së raportit të audituesit⁷;
- Zbatimi i mëhershëm (kur lejohet) i një standardi të ri të kontabilitetit që ka efekt material në pasqyrat financiare;
- Një katastrofë e madhe që ka pasur ose vazhdon të ketë një efekt të rëndësishëm në pozicionin financiar të entitetit.

A6. Megjithatë, një përdorim i gjerë i Paragrafit që thekson çështjen mund të zvogëlojë efektivitetin e komunikimit të audituesit për këto çështje.

Përfshirja në Raportin e Audituesit e një Paragrafi që Thekson Çështje (Ref: Para. 9)

A7. Përfshirja në Raportin e Audituesit e një paragrafi që thekson çështje, nuk ndikon në opinionin e audituesit. Një paragraf që thekson çështje nuk zëvendëson:

- (a) Një opinion të modifikuar në pajtim me SNA 705 (i rishikuar) kur kërkohet nga rrethanat e një angazhimi auditimi të veçantë (specifik);
- (b) Dhënien e informacioneve shpjeguese në pasqyrat financiare që sipas kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar kërkohet të bëhen nga drejtimi, apo që janë të nevojshme për të arritur paraqitjen e drejtë; ose
- (c) Raportimin në përputhje me SNA 570 (i rishikuar)⁸ kur ka një pasiguri materiale për ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha mbi aftësinë e entitetit për të vijuar veprimtarinë në vazhdimësi.

A8. Paragrafët A16-A17 japin udhëzime të mëtejshme për vendosjen e paragrafëve për theksim çështjesh në rrethana të caktuara.

Paragrafët për Çështje të Tjera në Raportin e Audituesit (Ref: Para.10-11)

Rrethanat kur mund të jetë i nevojshëm një paragraf për çështje të tjera

Rrethana që lidhen me kuptimin e auditimit nga përdoruesit

⁷ SNA 560, paragrafi 6

⁸ SNA 570 (i rishikuar), paragrafët 22-23

A9. SNA 260 (i rishikuar) kërkon që audituesi të komunikojë me personat e ngarkuar me qeverisjen në lidhje me objektin e planifikuar dhe afatet e auditimit, ku përfshihen komunikimet rreth rreziqeve të rëndësishëm të identifikuara nga audituesi⁹. Megjithëse çështjet që lidhen me rreziqet e mëdha mund të përcaktohen si çështje kryesore të auditimit, çështje të tjera që kanë të bëjnë me planifikimin dhe objektin (për shembull, objekti i planifikuar i auditimit, ose zbatimi i materialitetit në kontekstin e auditimit) ka pak të ngjarë të jenë çështje kryesore të auditimit, për shkak të përkufizimit për çështjet kryesore të auditimit në SNA 701. Megjithatë, ligji ose rregullat mund të kërkojnë që audituesi të komunikojë në raportin e audituesit lidhur me çështjet e planifikimit dhe të objektit, ose ndryshe, audituesi mund të shikojë mundësinë që t'i komunikojë këto çështje në paragrafin për çështje të tjera.

A10. Në raste të rralla, kur audituesi nuk mund të tërhiqet nga një auditim edhe pse efekti i mundshëm i pamundësisë për të marrë evidencën e nevojshme të auditimit për shkak të kufizimit në fushën e veprimit të auditimit të vendosur nga drejtimi është shumë i përhapur¹⁰, audituesi mund të konsiderojë të nevojshme të përfshijë në raportin e tij një paragraf për çështje të tjera për të shpjeguar përse nuk është e mundur që ai të tërhiqet nga angazhimi.

Rrethana që lidhen me kuptimin nga përdoruesit të Përgjegjësive të Audituesit ose të Raportit të Audituesit

A11. Ligji, rregulloret ose praktikat e pranura gjerësisht në një juridiksion të caktuar, mund të kërkojnë ose lejojnë audituesin të japë hollësi për çështjet që japin shpjegim të mëtejshëm të përgjegjësive të audituesit në auditimin e pasqyrave financiare ose për raportin e audituesit mbi këto pasqyra. Kur seksioni për çështje të tjera përfshin më shumë se një çështje, që sipas gjykimit të audituesit, lidhen me kuptimin nga përdoruesit të auditimit, të përgjegjësive të audituesit ose të raportit të audituesit, për çdo çështje mund të përdoren nëntituj të ndryshëm.

A12. Një paragraf për çështje të tjera nuk trajton rrethanat në të cilat audituesi ka përgjegjësi të tjera të raportimit, të cilat janë si shtesë e përgjegjësive të audituesit sipas SNA-ve për të raportuar mbi pasqyrat financiare (shiko seksionin “Përgjegjësi të Tjera të Raportimit” në SNA 700 (i rishikuar)¹¹), ose kur audituesit i është kërkuar për të kryer dhe raportuar mbi procedura të specifikuara shtesë, ose për të shprehur një opinion për çështje të veçanta.

⁹ SNA 260 (i rishikuar), paragrafi 15

¹⁰ Për trajtimin e këtij rasti, shiko paragrafin 13(b)(ii) të SNA 705.

¹¹ SNA 700 (i rishikuar), *Formimi i një Opinioni dhe Raportimi mbi Pasqyrat Financiare*, paragrafët 42-44

Raportimi për më shumë se një Paketë të Pasqyrave Financiare

A13. Një entitet mund të përgatitë një paketë të pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin për qëllime të përgjithshme (për shembull, kuadrin kombëtar) dhe një paketë tjetër të pasqyrave financiare në përputhje me një kuadër tjetër për qëllime të përgjithshme (për shembull, Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar), dhe e angazhon audituesin për të raportuar për të dy paketat e pasqyrave financiare. Nëse audituesi ka përcaktuar se të dy kuadrot janë të pranueshëm në rrethanat përkatëse, audituesi mund të përfshijë në raportin e tij një Paragraf për Çështje të Tjera, duke ju referuar faktit që një paketë tjetër e pasqyrave financiare është përgatitur nga i njëjti entitet në përputhje me kuadrin për qëllime të përgjithshme dhe se audituesi ka lëshuar një raport mbi këto pasqyra financiare.

Kufizimi në Shpërndarjen apo Përdorimin e Raportit të Audituesit

A14. Pasqyrat financiare të përgatitura për qëllime të veçanta mund të jenë përgatitur në përputhje me një kuadër për qëllime të përgjithshme për arsye se përdoruesit e synuar kanë përcaktuar se pasqyrat financiare për qëllime të përgjithshme plotësojnë kërkesat e tyre për informacion financiar. Meqenëse raporti i audituesit është parashikuar për përdorues të veçantë, audituesi mund ta konsiderojë të nevojshme për rrethanat që të përfshijë një paragraf për çështje të tjera duke deklaruar që raporti i audituesit është destinuar vetëm për përdoruesit e synuar dhe nuk mund të shpërndahet ose të përdoret nga palët e tjera.

Përfshirja në Raportin e Audituesit e një Paragrafi për Çështje të Tjera

A15. Përmbajtja e një paragrafi për çështje të tjera, reflekton në mënyrë të qartë faktin se këto çështje të tjera nuk kërkohet të paraqiten ose të shpjegohen në pasqyrat financiare. Një paragraf për çështje të tjera nuk do të përfshijë atë informacion për të cilin audituesi është i ndaluar nga ligji, rregullat ose standardet profesionale, për shembull, standardet etike që lidhen me konfidencialitetin e informacionit. Gjithashtu, një paragraf për çështje të tjera nuk do të përfshijë informacionin që kërkohet të jepet nga Drejtimi.

Vendosja në raportin e audituesit e Paragrafëve që Theksojnë Çështje dhe e Paragrafëve për Çështje të Tjera (Ref: Para. 9,11)

A16.Vendosja në raportin e audituesit e një paragrafi që thekson çështje ose një paragrafi për çështje të tjera varet nga natyra e informacionit që do të komunikohet dhe gjykimi i audituesit në lidhje me rëndësinë relative të këtyre informacioneve për përdoruesit e synuar krahasuar me elementet e tjerë që kërkohet të raportohen në pajtim me SNA 700 (i rishikuar). Për shembull:

Paragrafët e Theksimit të Çështjes

- Kur një paragraf që thekson një çështje lidhet me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar, përfshirë rrethanat kur audituesi përcakton se kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar i përshkruar me ligj ose nga rregullat do të ishte i papranueshëm¹² audituesi mund të konsiderojë vendosjen e paragrafit menjëherë pas seksionit të Bazës për Opinionin, për të dhënë kontekstin e duhur për opinionin e audituesit.
- Kur në raportin e audituesit është paraqitur një seksion për Çështjet Kryesore të Auditimit, një paragraf që thekson një çështje mund të paraqitet direkt para ose pas seksionit për Çështjet Kryesore të Auditimit, bazuar në gjykimin e audituesit lidhur me rëndësinë relative të informacionit të përfshirë në paragrafin për theksimin e çështjes. Gjithashtu, me qëllim që të diferencojë paragrafin për theksimin e çështjes nga çështjet e veçanta të përshkruara në seksionin për Çështjet Kryesore të Auditimit, audituesi mund të shtojë përshkrimin tek titulli “Theksimi i çështjes”, si për shembull “Theksimi i çështjes – Ngjarjet e mëvonshme”.

Paragrafët për Çështje të Tjera

- Kur në raportin e audituesit është paraqitur një seksion për Çështjet Kryesore të Auditimit, dhe gjithashtu është konsideruar i nevojshëm edhe një paragraf për çështje të tjera, me qëllim që të diferencojë paragrafin për çështje të tjera nga çështjet e veçanta të përshkruara në seksionin për Çështjet Kryesore të Auditimit, audituesi mund të shtojë përshkrimin tek titulli “çështje të tjera”, për shembull, “çështje të tjera – objekti i auditimit”.

¹² Për shembull, sikurse kërkohet nga SNA 210, *Rënia dakord me kushtet e angazhimit të auditimit, paragrafi 19, dhe SNA 800, Konsiderata të veçanta - Auditimet e pasqyrave financiare të përgatitura sipas kuadrove për qëllime specifike, paragrafi 14*

PARAGRAFËT QË THEKSOJNË ÇËSHTJEN DHE PARAGRAFËT PËR ÇËSHTJE TË TJERA NË RAPORTIN E AUDITUESIT TË PAVARUR

- Kur përfshihet një paragraf për çështje të tjera, me qëllim që të tërheqë vëmendjen e përdoruesve për një çështje që lidhet me Përgjegjësitë e tjera të raportimit të adresuar në raportin e audituesit, paragrafi mund të përfshihet në seksionin e Raportimit mbi Kërkesat e tjera Ligjore dhe Rregullatore.
- Kur paragrafi për çështjet e tjera lidhet me të gjitha aspektet që nga përgjegjësitë e audituesit ose kuptimin prej përdoruesve të raportit të audituesit, ky paragraf mund të përfshihet në raport si një seksion i veçantë pas Raportit mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare dhe Raportit mbi Kërkesa të Tjera Ligjore dhe Rregullatore.

A17. Shtojca 3 është një ilustrim i ndërveprimit midis seksionit për Çështjet Kryesore të Auditimit, paragrafit që thekson një çështje dhe paragrafit për çështje të tjera, kur të gjitha këto paraqiten në raportin e audituesit. Raporti ilustrues në shtojcën 4 përfshin një paragraf për theksimin e çështjes në raportin e audituesit të një entiteti që nuk është i listuar, i cili përmban një opinion me rezervë dhe për të cilin nuk janë komunikuar Çështjet Kryesore të Auditimit.

Komunikimi me Personat e Ngarkuar me Qeverisjen (Ref: Para.12)

A18. Komunikimi i kërkuar nga paragrafi 12 ju mundëson personave të ngarkuar me qeverisjen të bëhen me dije për natyrën e ndonjë çështje të veçantë që audituesi ka për qëllim të nxjerrë në pah në raportin e audituesit, dhe i pajis ata me mundësinë për të marrë sqarime të mëtejshme nga audituesi kur është e nevojshme. Kur përfshirja në raportin e audituesit e një paragrafi për çështje të tjera përsëritet në çdo angazhim të mëpasshëm, audituesi mund të përcaktojë si të panevojshme të përsëritë komunikimin mbi çdo angazhim, përveç nëse ai detyrohet nga ligji ose rregullat për të komunikuar.

Shtojca 1

(Ref: Para. 4, A4)

Lista e SNA-ve që Përmbajnë Kërkesa për Paragrafët që Theksojnë Çështje

Kjo shtojcë identifikon paragrafët në SNA-të e tjera, të cilat kërkojnë që audituesi të përfshijë në raportin e tij, në disa rrethana të caktuara, një paragraf që thekson çështjen. Kjo listë nuk zëvendëson kërkesat, zbatimet përkatëse dhe materialet e tjera shpjeguese të dhëna në SNA-të.

- SNA 210, *Rënia Dakord me Kushtet e Angazhimit të Auditimit*– paragrafi 19(b)
- SNA 560, *Ngjarjet e Mëvonshme* – paragrafët 12(b) dhe 16
- SNA 800, *Konsiderata të Veçanta – Auditimi i Pasqyrave Financiare të Përgatitura në Pajtim me një Kuadër për Qëllime të Veçanta* – paragrafi 14

Shtojca 2

(Ref: Para. 4)

Lista e SNA-ve qe Përmbajnë Kërkesa për Paragrafët me Çështje të Tjera

Kjo shtojcë identifikon paragrafët në SNA-të e tjera, të cilat kërkojnë që audituesi të përfshijë në raportin e audituesit, në disa rrethana të caktuara, paragrafë për çështje të tjera. Kjo listë nuk zëvendëson kërkesat, zbatimet përkatëse dhe materialet e tjera shpjeguese të dhëna në SNA-të.

- SNA 560, *Ngjarjet e Mëvonshme* – paragrafët 12(b) dhe 16
- SNA 710, *Informacionet Krahasuese – Shifrat Korresponduese dhe Pasqyrat Financiare Krahasuese* – paragrafët 13-14, 16-17, dhe 19
- SNA 720, *Përgjegjësitë e Audituesit në Lidhje me Informacionet e Tjera në Dokumentet që Përmbajnë Pasqyrat Financiare të Audituar* – paragrafi 10(a)

Shtojca 3

(Ref: Para. A17)

Ilustrimi i një Raporti të Audituesit që përfshin një Seksion për Çështjet Kryesore të Auditimit, një Paragraf që Thekson Çështjen dhe një Paragraf për Çështje të Tjera

Për qëllime të këtij raporti ilustrues të audituesit, supozohen rrethanat e mëposhtme:

- **Auditimi që kryhet është për një paketë të plotë të pasqyrave financiare të një entiteti të listuar, që përdor një kuadër të paraqitjes së drejtë. Auditimi nuk është auditim i një Grupi (d.m.th. nuk zbatohet SNA 600¹³).**
- **Pasqyrat financiare janë përgatitur nga drejtimi i entitetit në përputhje me SNRF-të (një kuadër për qëllime të përgjithshme).**
- **Kushtet e angazhimit të auditimit reflektojnë përshkrimin e përgjegjësisë së drejtimit për pasqyrat financiare, sipas SNA 210.**
- **Bazuar në evidencën e auditimit të siguar, audituesi ka arritur në përfundimin se duhet të jepet një opinion pa rezervë (i pastër).**
- **Kërkesat përkatëse etike që zbatohen për auditimin janë ato që janë në fuqi në juridiksionin përkatës (vendin përkatës).**
- **Bazuar në evidencën e auditimit të siguar, audituesi ka arritur në përfundimin se nuk ka pasiguri materiale për ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e entitetit për të vijuar veprimtarinë, në pajtim me SNA 570 (i rishikuar).**
- **Midis datës së pasqyrave financiare dhe datës së raportit të audituesit, në mjediset e prodhimit të entitetit ka rënë një zjarr, pasojat e të cilit janë shpjeguar nga entiteti si ngjarje të mëvonshme. Sipas gjykimit të audituesit, çështja ka një rëndësi të madhe për përdoruesit, që ata të kuptojnë pasqyrat financiare. Kësaj çështje nuk ju kushtua vëmendje e madhe nga audituesi gjate auditimit të pasqyrave financiare të periudhës aktuale.**
- **Çështjet Kryesore të Auditimit janë komunikuar në pajtim me SNA 701.**

¹³ SNA 600, *Konsiderata të veçanta – Auditimi i pasqyrave financiare të grupit (duke përfshirë punën e Audituesit të Entitetit të Kontrolluar)*

- **Pasqyrat financiare përmbajnë shifrat korresponduese; pasqyrat financiare të periudhës së mëparshme kanë qenë audituar nga një auditues i mëparshëm. Audituesi nuk ndalohet nga ligji ose nga rregullat për të referuar në raportin e tij, raportin e audituesit të mëparshëm për shifrat korresponduese dhe audituesi aktual e ka bërë këtë gjë.**
- **Ata që janë përgjegjës për mbikëqyrjen e pasqyrave financiare ndryshojnë nga ata që janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare.**
- **Përveç auditimit të pasqyrave financiare, audituesi ka përgjegjësi të tjera për të raportuar, të cilat kërkohen sipas legjislacionit lokal (të vendit përkatës).**

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për aksionarët e shoqërisë tregtare ABC [ose një adresë tjetër e duhur]

Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare¹⁴

Opinionin

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë tregtare ABC (shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 20X1, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, (ose japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë për) pozicionin financiar të shoqërisë me datën 31 Dhjetor 20X1, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit të Përgjegjësisë të Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare (të zbatueshme në juridiksionin përkatës) dhe kemi përmbushur edhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

¹⁴ Nëntitulli “Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare” nuk është i nevojshëm kur raporti nuk përmban një nëntitull të dytë të emërtuar “Raport mbi Kërkesat e Tjera Ligjore dhe Rregullatore”.

Theksimi i çështjes¹⁵

Ne tërheqim vëmendjen për shënimin X të pasqyrave financiare, ku përshkruhen efektet e një zjarri që ka rënë në mjediset e prodhimit të shoqërisë. Opinioni ynë nuk është modifikuar për këtë çështje.

Çështjet Kryesore të Auditimit

Çështje Kryesore të Auditimit janë ato çështje që, në gjykimin tonë profesional, kanë qënë më të rëndësishmet në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje kanë qënë adresuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi dhe të formimit të opinionit tonë në lidhje me to, kështu që për këto çështje ne nuk japim opinion të veçantë.

[Përshkrimi për çdo çështje kryesore të auditimit në pajtim me SNA 701.]

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare¹⁶

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar)– shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

Raport mbi Kërkesa të tjera Ligjore dhe Rregullatore

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

Ortaku i angazhimit për auditimin përgjegjës për raportin e auditimit është [emri]

[Nënshkrimi në emër të firmës së auditimit, emrin personal të audituesit ose të dyja bashkë, cilado është e përshtatshme në juridiksionin e caktuar]

[Adresa e audituesit]

[Data]

¹⁵ Sikurse tregohet në paragrafin A16, një paragraf për theksimin e një çështje është i panevojshëm në rastet kur nuk zbatohet një nëntitull i dytë “Raport mbi kërkesat e tjera ligjore dhe Rregullatore”.

¹⁶ Në të gjitha këto raporte audituesi ilustruese, termat drejtimi dhe personat e ngarkuar me qeverisjen mund të zëvendësohen me një term tjetër që është i përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor që zbatohet në një juridiksion të caktuar.

¹⁷ Nëntitulli “Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare” nuk është i nevojshëm kur raporti nuk përmban një nëntitull të dytë të emërtuar “Raport mbi Kërkesat e Tjera Ligjore dhe Rregullatore”.

Shtojca 4

(Ref: Para. A8)

Ilustrimi i një Raporti të Audituesit që përmban një Opinion me Rezervë për shkak të një devijimi nga Kuadri i Zbatueshëm i Raportimit Financiar dhe që përfshin një Paragraf që Thekson Çështje.

Për qëllime të këtij raporti ilustrues të audituesit, supozohen rrethanat e mëposhtme:

- Auditimi që kryhet është për një paketë të plotë të pasqyrave financiare të një entiteti të pa listuar, që përdor një kuadër të paraqitjes së drejtë. Auditimi nuk është auditim i një Grupi (d.m.th. nuk zbatohet SNA 600).
- Pasqyrat financiare janë përgatitur nga drejtimi i entitetit në përputhje me SNRF-të (një kuadër për qëllime të përgjithshme).
- Kushtet e angazhimit të auditimit reflektojnë përshkrimin e përgjegjësisë së drejtimit për pasqyrat financiare, sipas SNA 210.
- Një devijim nga kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar ka çuar në dhënie e një opinionimi me rezervë.
- Kërkesat përkatëse etike që zbatohen për auditimin janë ato që janë në fuqi në juridiksionin përkatës (vendin përkatës).
- Bazuar në evidencën e auditimit të siguruar, audituesi ka arritur në përfundimin se nuk ka pasiguri materiale për ngjarjet ose kushtet të cilat mund të hedhin dyshime të mëdha lidhur me aftësinë e entitetit për të vijuar veprimtarinë, në pajtim me SNA 570 (i rishikuar).
- Midis datës së pasqyrave financiare dhe datës së raportit të audituesit, në mjediset e prodhimit të entitetit ka rënë një zjarr, pasojat e të cilit janë shpjeguar nga entiteti si ngjarje të mëvonshme. Sipas gjykimit të audituesit, çështja ka një rëndësi të madhe për përdoruesit që ata të kuptojnë pasqyrat financiare. Kësaj çështje nuk ju kushtua vëmendje e madhe nga audituesi gjatë auditimit të pasqyrave financiare të periudhës aktuale.
- Audituesi nuk kërkohet dhe ai nuk ka vendosur të komunikojë Çështjet Kryesore të Auditimit në pajtim me SNA 701.
- Ata që janë përgjegjës për mbikëqyrjen e pasqyrave financiare ndryshojnë nga ata që janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare.
- Përveç auditimit të pasqyrave financiare, audituesi ka përgjegjësi të tjera për të raportuar, të cilat kërkohen sipas legjislacionit lokal (të vendit përkatës).

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për aksionarët e shoqërisë tregtare ABC [ose një adresë tjetër e duhur]

Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare¹⁷

Opinionin me rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë tregtare ABC (shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 20X1, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjes së përshkruar në seksionin e Bazës për Opinionin me rezervë të raportit, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, (ose japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë për) pozicionin financiar të shoqërisë me datën 31 Dhjetor 20X1, dhe performancën financiare e flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin me rezervë

Letrat me vlerë të tregtueshme afatshkurtra të shoqërisë janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në shumën xxx. Drejtimi nuk i ka tregtuar këto letra dhe i ka paraqitur me kosto, çka përbën një devijim nga SNRF-të. Regjistrimet e shoqërisë tregojnë se nëse drejtimi do t'i kishte paraqitur letrat me vlerë me vlerën e tregut, shoqëria duhet të kishte regjistruar një humbje të parealizuar në shumën xxx në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse të vitit. Vlera kontabël e letrave me vlerë në pasqyrën e pozicionit financiar do të ishte zvogëluar për të njëjtën shumë me datën 31 Dhjetor 20X1 dhe tatimi mbi të ardhurat, e ardhura neto dhe kapitali i aksionarëve do të ishin zvogëluar respektivisht me xxx, xxx dhe xxx.

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit të Përgjegjësisë të Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare (të zbatueshme në juridiksionin përkatës) dhe kemi përmbushur edhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë me rezervë.

¹⁷ Nëntitulli “Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare” nuk është i nevojshëm kur raporti nuk përmban një nëntitull të dytë të emërtuar “Raport mbi Kërkesat e Tjera Ligjore dhe Rregullatore”.

Theksimi i çështjes - Pasojat e zjarrit

Ne tërheqim vëmendjen për shënimin X të pasqyrave financiare, ku përshkruhen efektet e një zjarri që ka rënë në mjediset e prodhimit të shoqërisë. Opinioni ynë nuk është modifikuar për këtë çështje.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare¹⁸

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar)– shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

Raport mbi Kërkesa të Tjera Ligjore dhe Rregullatore

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

Ortaku i angazhimit për auditimin përgjegjës për raportin e auditimit është [emri]

[Nënshkrimi në emër të firmës së auditimit, emrin personal të audituesit ose të dyja bashkë, cilado është e përshtatshme në juridiksionin e caktuar]

[Adresa e audituesit]

[Data]

¹⁸ Në të gjitha këto raporte audituesi, ilustruese, termat drejtimi dhe personat e ngarkuar me qeverisjen mund të zëvendësohen me një term tjetër që është i përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor që zbatohet në një juridiksion të caktuar.